



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Komisioni Qendror i Zgjedhjeve
Centralna Izborna Komisija
Central Election Commission



Prishtinë/Prishtina, rr./ul. Migjeni p.n/b.b; tel. +381 (0) 38 211 337; kqz.sekretariati@kqz.kg.gov.kg; kqz.org
Në pajtim me autorizimet e dhëna me nenin 63, 63.11, 64 të Ligjit Nr.03/L-073 për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës, bazuar në vendimin e PZAP-së, nr. ZL.Anr.2014/2017, si dhe vendimin e Gjykatës Supreme AA.nr.55/2017, Komisioni Qendror i Zgjedhjeve në mbledhjen rregullt të mbajtur me datën 02.12.2017, nxjerr këtë:



VENDIM

Për Miratimin e Procedurës për Verifikimin dhe Konfirmimin e Votuesve Jashtë Kosovës për Zgjedhjet e Përsëritura për Raudin e Dytë për Kryetar Komune në Istog

- I. Miratohet procedura për Verifikimin dhe konfirmimin e votuesve jashtë Kosovës, për zgjedhjet e përsëritura për raundin e dytë për Kryetar Komune në Istog, që do të mbahen më datën 17.12.2017.
- II. Gjatë periudhës së verifikimit dhe konfirmimit, votuesit e regjistruar suksesshëm jashtë Kosovës, duhet që të dërgojnë:
 - a) Dëshmi zyrtare që dëshmon adresën e vendbanimit jashtë Kosovës, dhe
 - b) Numrin kontaktues të telefonit.
- III. Votuesit jashtë Kosovës duhet të dërgojnë dëshmi zyrtare shtesë për adresën e vendbanimit jashtë Kosovës dhe numrin e telefonit kontaktues, që do të kontaktohen për verifikim, ku do të vërtetohet se a janë votues që kanë aplikuar suksesshëm dhe personalisht nga jashtë Kosovës.
- IV. Votuesit e regjistruar jashtë Kosovës përgjatë datës 16.07.2017 deri me datën 23.08.2017, të cilët nuk do të konfirmojnë adresën dhe numrin kontaktues, do të kthehen si votues në listën e votuesve brenda Kosovës, sipas adresave të tyre në Regjistrin Qendror Civil.
- V. Pezullohen –shmangen nenet 6 dhe 8 të Rregullës Zgjedhore nr. 10/2013 për Zgjedhjet e Raundit të Dytë për Kryetar të Komunave.
- VI. Periudha e verifikimit dhe konfirmimit të votuesve jashtë Kosovës do të filloj me datën 02.12.2017 deri me datën 06.12.2017.
- VII. Obligohet Sekretariati i KQZ-së për zbatimin e këtij vendimi.
- VIII. Ky vendim hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Arsyetim

Bazuar në vendimin e PZAP-së nr.ZL.Anr.1114/2017 si dhe vendimin e Gjykatës Supreme nr.AA.55/2017, KQZ në mënyrë unanime vendosi të zbatoj këto vendime . Andaj u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

Prishtinë, 02.12. 2017

Kryetare e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve

Valdete Daka

